



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 20

Prishtinë, më 29.3.2018, në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla – N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Korab Sejdiu, Nezir Çoçaj, Igor Simiq, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

Munguan: Glauk Konjufca, dhe Arben Gashi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Ardian Bajraktari, MD; Albert Krasniqi; Shaban Murturi dhe Edita Kusari, EUSR/EUO; Gzim Shala, IKD/BPD; Valbona Bytyqi, Ekonomia Online; Rreze Hoxha, GLPS; Ismail Shabani, Kosova Press; dhe Ertur Maloku, Ambasada e SHBA-së

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me 6.02 dhe 13.2.2018;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034;
5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-026 për Azil;

6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt;
7. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim;
8. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-037 për metrologji;
9. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit;
10. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-029 për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore;
11. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me 6.2.2018 dhe 13.2.2018;

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 6.2.2018 dhe 13.2.2018, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;

Sami Kurteshi, në emër të kryesuesit të Grupit punues arsyetoi raportin me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Ai tha se nuk është një draft i përkryer, por duke pas parasysh vendimin e Kuvendit që në këto Projektligje të punohet me procedura të përsheptuara, tha se si grup punues kemi punuar intenzivisht për dy ditë dhe Komisionit i kemi paraqit 37 amendamente për miratim.

Kryetarja, në cilësinë e propozuesit arsyetoi amendamentin 25, ku thuhet se “Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë më shumë se një funksion në sektorin publik, përveç rasteve kur është i caktuar sipas detyrës zyrtare”. Ajo tha se ky amendament ka për qëllim që të vendosë një rregull që do të pamundësojë që zyrtaret e lartë të mbajnë më shumë se një funksion publik dhe si i tillë shmang konfliktin e interesit në pozitat e larta.

Anëtarët e Komisionit, Korab Sejdiu, Sami Kurteshi, Bilall Sherifi, Hajdar Beqa, NezirÇoçaj Shkumbin Demalijaj, diskutuan për amendamentin e propozuar.

Për amendamentin 25 votuan Albulena Haxhiu, Korab Sejdu, dhe Sami Kurteshi, kurse kundër votuan “Hajdar Beqa, Bilall Sherifi, Bahrim Shabani, NezirÇoçaj dhe Shkumbin Demalijaj.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se me 3 vota “për” dhe 5 vota “kundër “ Komisioni nuk përkrahu amendamentin 25, të propozuar nga deputetët Ismajl Kurteshi dhe Albulena Haxhiu.

Meqë nuk pati diskutime tjera, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Rekomandim

I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit;

II. Projektligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet kryesore;

III. Amendamentet e miratuara dhe të papërkrahura nga Komisioni, janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034;

Hajdar Beqa, në emër të kryesuesit të grupit punues, arsyetoi raportin me amendamente në Projektligjin nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034. Ai tha se grupi punues, në bashkëpunim me të gjitha palët e interesit dhe në koordinim me ministrin e Drejtësisë, ka paraqitur 6 amendamente. Në disa nene kemi nga dy propozime dhe kërkoj nga Komisioni që të përkrahen vetëm amendamentet që kemi propozuar si grup punues, pasi që janë bërë në koordinim të plotë me të gjitha palët e interesit dhe janë në funksion të ngritjes së efikasitetit në zbatim të ligjit. Beqajpropozoi që neni 3 i Projektligjit të riformulohet si vijon:

“Neni 25, i Ligjit bazik, riformulohet si vijon:

Neni 25

Veprimtaritë profesionale

1. Prokurori me aprovim paraprak të Kryeprokurorit të Prokurorisë, ndërsa, kryeprokurorët e Prokurorive, me aprovimin paraprak të Këshillit, kanë të drejtë të marrin pjesë në organizata profesionale, takime shkencore, të cilat promovojnë pavarësinë dhe mbrojtjen e interesave profesionale të prokurorëve.

2. Prokurori me aprovimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë dhe kryeprokurorët e Prokurorive me aprovim të Këshillit, vetëm jashtë orarit të punës, marrin pjesë në veprimtari të cilat janë në përputhje me Kodin e Etikës dhe sjelljen profesionale të prokurorëve.

3. Në pajtim me dispozitat e Kodit të Etikës dhe sjelljes profesionale të prokurorëve, prokurorët mund të angazhohen në shkrime profesionale dhe shkencore, por nuk mund të botojnë përmbajtjen relevante të dosjeve prokuroriale, gjatë apo pas përfundimit të funksionit prokurorial, përveç nëse kjo lejohet shprehimisht me ligj apo akt nënligjor, të lëshuar nga Këshilli.

4. Prokurorët dhe Kryeprokurorët, për aktivitetet e parapara në këtë nen, pranojnë shpërblim, i cili nuk mund të tejkalojë vlerën prej 25% (njëzetepesë) për qind të pagës bazë, dhe për këtë shpërblim prokurorët e njoftojnë Kryeprokurorin, kurse kryeprokurorët e njoftojnë Këshillin.

Kryetarja, tha se në lidhje me amendamentin 1, që ka propozuar si deputete, deklaroi se tërhiqet nga ky amendament dhe përkrahu propozimin e deputetit Korab Sejdu, që neni 1 i Projektligjit të hiqet në tërësi, kurse për amendamentet tjera të propozuara nga ajo, kërkoi përkrahjen e Komisionit.

Për amendamentet e propozuara nga Albulena Haxhiu dhe Korab Sejdiu, votuan Sami Kurteshi, Albulena Haxhiu, Korab Sejdiu dhe Bilall Sherfi, kurse kundër ishin Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, NezirÇoçaj dhe Shkumbin Demalijaj.

Komisioni pas diskutimeve, lidhur me amendamentet e propozuara, me 4 vota “për” dhe 4 vota “kundër” nuk përkrahu amendamentet e propozuara nga deputetët Korab Sejdiu dhe Albulena Haxhiu, ndërsa, amendamenti i deputetit Hajdar Beqa, për riformulimin e nenit 3 të Projektligjit u përkrah njëzëri nga Komisioni.

Meqë nuk pati diskutime tjera, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Rekomandim

I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit;

II. Projektligjin nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034 dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet kryesore;

III. Amendamentet e miratuara dhe të papërkrahura nga Komisioni, janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-026 për Azil;

Kryetarja, paraqiti para Komisionit Raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. nr. 06/L-026 për Azil, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-026 për Azil dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim;

6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt;

Kryetarja, paraqiti para Komisionit Raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. nr. 06/L-036, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim;

7. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim;

Kryetarja, paraqiti para Komisionit Raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim;

8. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në projektligjin nr. 06/L-037 për Metrologji;

Kryetarja, paraqiti para Komisionit Raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-037 për Metrologji, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-037 për Metrologji dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim;

9. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në projektligjin nr. 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit;

Kryetarja, paraqiti para Komisionit Raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim;

10. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në projektligjin nr. 06/L-029 për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore;

Kryetarja, paraqiti para Komisionit Raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-029 mbi mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-029 për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim;

11. Të ndryshme.

Komisioni, me propozim të deputetit Korab Sejdiu, vendosi që për hartimin e Projektligjit për Familjen, të angazhohet eksperti Idriz Tahiri.

Mbledhja përfundoi në orën 16:25

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu

Aneks- Amendamentet e propozuara në Projektligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;

Amendamenti 1

Në nenin 2 të Projektligjit, në rreshtin e dhjetë fjalët “**interesave publike**” zëvendësohet me fjalët “ **interesit publik**” dhe teksti vazhdon si në projektligj, si dhe në rreshtin e njëmbëdhjetë pas fjalës “**gjatë**” shtohen fjalët “ **dhe pas**” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 2

Në nenin 3,në-paragrafi 1.2 riformulohet si vijon:

” **1.2 “interes privat i personit zyrtar** – nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste.”

Amendamenti 3

Në nenin 3 nën-paragrafi 1.3 **hiqen** fjalët ” dhe të gjithë ushtruesit e funksioneve publike të emëruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Kryeministri, si dhe ministrat, e që nuk përmendën shprehimisht sipas këtij nënparagrafi.

Amendamenti 4

Në nenin 3,nënparagrafi 1.6 në rreshtin katërbëdhjetë fjalët “në kuptim të nenit 424 (5) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ose ligjin pasues.” zëvendësohen me fjalët “ sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.”

Amendamenti 5

Në nenin 3,nënparagrafi 1.7 në rreshtin e nëntë fjala “fwmijwt” zëvendësohet me “fëmijët” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 6

Në nenin 3,nënparagrafi 1.11 riformulohet si vijon:

“1.11 **Dhuratë** –e përcaktuar sipas Ligjit përkatës për deklarinimin, kontrollin dhe prejardhjen e pasurisë”

Nenin 3,nënparagrafi 1.14 bëhet paragraf 2 dhe riformulohet si vijon:” 2. Fjalët e një gjinie përfshinë edhe gjininë tjetër.

Amendamenti 7

Në nenin 4 në rreshtin e dytë hiqen fjalët “**në dispozitat specifike të këtij ligji**” dhe zëvendësohen me fjalët “**me këtë ligj**” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 8

Në nenin 5, paragrafi 3 në rreshtin e katërt fjala “**vërë**” zëvendësohet me “**vë**” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 9

Neni 5 paragrafi 6 riformulohet si vijon:

“6. Zyrtarit nuk i lejohe të kryejë një veprim të kundërligjshëm apo të mos kryejë një veprim të ligjshëm, gjatë ushtrimit të funksionit të tij, me qëllim të marrjes së një përfitimi të padrejtë për vete ose një person apo subjekt tjetër.”

Amendamenti 10

Neni 5, paragrafi 8 riformulohet si vijon:

“8. Zyrtari duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, i mundshëm apo në dukje.”

Amendamenti 11

Në nenin 6, në rreshtin e pestë fjala “**publike**” zëvendësohet me “**zyrtare**”.

Amendamenti 12

Në nenin 7 paragrafi 2 në rreshtin e tret fjalët “**kanë të drejtë**” zëvendësohen me “**duhet**” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 13

Në nenin 8, paragrafi 2 në rreshtin e tret lidhëza “**me**” hiqet dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 14

Në nenin 8, paragrafi 4 në rreshtin e katërt fjala “**ai**” zëvendësohet me “**vetë**” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 15

Në nenin 9, paragrafi 1 riformulohet si vijon:

“1. Gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit i ndalohen këto veprime:”

Amendamenti 16

Në nenin 9,nënparagrafi 1.1 riformulohet si vijon:

“1.1 të kërkojë apo pranojë dhuratë apo përfitim tjetër të padrejtë për vete apo personin tjetër, ose ofertë apo premtim për dhuratë, në mënyrë që zyrtari të veprojë ose të mos veprojë në kryerjen e detyrës së tij publike.”

Amendamenti 17

Në nenin 9,nënparagrafi 1.2 hiqet dhe renditja e nënparagrafëvetë tjerë bëhet sipas radhës.

Amendamenti 18

Në nenin 9,nënparagrafi 1.3 në rreshtin e katërt fjala “ **të votës së** “ zëvendësohet me “ **për përcaktimin e** “ dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 19

Në nenin 9,nënparagrafi 1.4 riformulohet si vijon:

“1.4. të ndikojë në vendimin e ndonjë zyrtari apo organi për arsye të përfitimit të padrejtë për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik.”

Amendamenti 20

Në nenin 9,nënparagrafi 1.6 fjalët “personale apo të personave të afërm ose të besuar” zëvendësohen me “**për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik;**”

Amendamenti 21

Neni 9,nënparagrafi 1.7 riformulohet si vijon:

“1.7 të shfrytëzojë informatat e besueshme që i ka në dispozicion apo të marra në mirëbesim në ushtrimin e funksionit për përfitime të padrejta për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik, të bashkaksionarëve apo personave në lidhje të mëhershme afariste në 5 (pesë) vitet e fundit;”

Amendamenti 22

Neni 9,nënparagrafi 1.8 riformulohet si vijon:

1.8 të ndikojë në vendimmarrje të organeve legjislativë, gjyqësore apo ekzekutive duke shfrytëzuar pozitën e zyrtarit me qëllim të përfitimit të padrejtë për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik, të bashkaksionarëve apo personave në lidhje të mëhershme afariste në 5 (pesë) vitet e fundit;”

Amendamenti 23

Neni 9 nënparagrafi 1.9 riformulohet si vijon:

“1.9. të ndërmarrë veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t’i përshtaten interesit personal të tij apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik, të bashkaksionarëve apo personave në lidhje të mëhershme afariste në 5 (pesë) vitet e fundit;”

Amendamenti 24

Neni 10, paragrafi 4 hiqet.

Amendamenti 25 propozim i deputetëve Ismajl Kurteshi dhe Albulena Haxhiu-pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Në nenin 12, pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri 3 me përmbajtjen si vijon:

“Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë më shumë se një funksion në sektorin publik, përveç rasteve kur është i caktuar sipas detyrës zyrtare”

Amendamenti 26

Neni 14, paragrafi 1 riformulohet si vijon:

“1. Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i organit drejtues të organizatës jo-qeveritare.”

Amendamenti 27

Neni 14, paragrafi 2 në rreshtin e pestë hiqen fjalët “ **i organit drejtues**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 28

Neni 15, paragrafi 1 riformulohet si vijon:

” 1. Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë në mënyrë aktive të drejtën e administrimit dhe drejtimit në një ndërmarrje, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj.”

Amendamenti 29

Neni 15, paragrafi 6 në rreshtin e katërt pas fjalës “biznesin” shtohen fjalët “të deklarohet për biznesin,” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 30

Neni 16, paragrafi 1 në rreshtin e gjashtë fjala “mënjanohet” zëvendësohet me fjalën “ shmang” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 31

Neni 16, paragrafi 4 riformulohet si vijon:

“4. Nëse konstatohet se votimi dhe vendimi është marrë në kundërshtim me paragrafin 3 të këtij neni ai shpallet i pavlefshëm nga institucioni përkatës.”

Amendamenti 32

Neni 19,nënparagrafi 1.1 fjalët “interesat privatë” zëvendësohet me fjalët “ interesin privat” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 33

Neni 19, paragrafi 3 në rreshtin e katërt fjala “ çlirohen” zëvendësohet me fjalën “ përjashtohen” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 34

Neni 21,nënparagrafi 1.5 në rreshtin e parë fjala “ ndaj zyrtarëve” zëvendësohet me fjalën “ për zyrtarët” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 35

Neni 22, paragrafi 16 riformulohet si vijon:

“16. Për të gjitha rastet e iniciuara të konfliktit të interesit përmes autoriteteve përgjegjëse, Agjencia vendos në një afat brenda 45 ditësh. Për rastet tjera vlejné afatet e përcaktuara me ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit. “

Amendamenti 36

Në tërë nenin 23 hiqen kllapat ku janë vendosur shumat për gjobat.

Amendamenti 37

Në nenin 24, para paragrafit 1 shtohet një paragraf i ri me përmbajtjen si vijon:

“1. Çdo shkelje e dispozitave të këtij ligji do të konsiderohet edhe si shkelje disiplinore, pavarësisht përgjegjësive eventuale penale. Shkeljet disiplinore trajtohen në pajtim me rregullat

që i rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe statusin e zyrtarëve. Institucionet/organizatat që i kanë iniciuar procedurat disiplinore sipas këtij ligji duhet ta njoftojnë Agjencinë për inicimin dhe rezultatin e atyre procedurave.”

Paragrafi 1 i Projektligjit bëhet paragrafi 2 dhe renditja vazhdon sipas numrave me radhë.

Aneks- Amendamentet e propozuara në Projektligjin nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034

Amendamenti 1 - dy propozime

A. Propozim i Komisionit FunkSIONAL

Neni 1 paragrafi 1 i Projektligjit riformulohet si vijon:

“1. Neni 11 i Ligjit bazik, nënparagrafi 1.3, pas fjalës “Kosovës”, shtohet fjalia”përfshirë hetimin dhe ndjekjen penale, si pjesë e ushtrimit të funksioneve prokuroriale.”

B. Propozim i Deputetit Korab Sejdiu - pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 1 paragrafi 1 të hiqet.

Amendamenti 2 - dy propozime

A. Propozim i Komisionit FunkSIONAL

Neni 1 paragrafi 2 i Projektligjit fjalët “2. Në nenin 1 të Ligjit të ndryshuar, pas nënparagrafit 1.7, shtohen nënparagrafët si në vijim:” **zëvendësohen me fjalët** “2. Neni 11 i Ligjit bazik, pas nënparagrafit 1.7, shtohen nënparagrafët 1.7a dhe 1.7b me tekstin si në vijim:” dhe pjesa tjetër e tekstit vazhdon si në Projektligj.

B. Propozim i Deputetit Korab Sejdiu - pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 1 paragrafi 2 i Projektligjit, të hiqet.

Amendamenti 3

Neni 2 i Projektligjit, fjalët “Neni 8 i Ligjit të ndryshuar, nënparagrafi 4.1 dhe 4.3, riformulohet si në vijim:” **zëvendësohen me fjalët** “1. Neni 20 i Ligjit bazik, nënparagrafi 4.1 dhe 4.3, riformulohen me tekstin si në vijim:” dhe pjesa tjetër e tekstit vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 4

Neni 3 i Projektligjit riformulohet si vijon:

“Neni 25, i Ligjit bazik, riformulohet si vijon:

Neni 25 Veprimtaritë profesionale

1. Prokurori me aprovim paraprak të Kryeprokurorit të Prokurorisë, ndërsa Kryeprokurorët e Prokurorive, me aprovimin paraprak të Këshillit, kanë të drejtë të marrin pjesë në organizata profesionale, takime shkencore, të cilat promovojnë pavarësinë dhe mbrojtjen e interesave profesionale të prokurorëve.

2. Prokurori me aprovimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë dhe Kryeprokurorët e Prokurorive me aprovim të Këshillit, vetëm jashtë orarit të punës, marrin pjesë në veprimtari të cilat janë në përputhje me Kodin e Etikës dhe sjelljen profesionale të prokurorëve.

3. Në pajtim me dispozitat e Kodit të Etikës dhe sjelljes profesionale të prokurorëve, prokurorët mund të angazhohen në shkrime profesionale dhe shkencore, por nuk mund të botojnë përmbajtjen relevante të dosjeve prokuroriale, gjatë apo pas përfundimit të funksionit prokurorial, përveç nëse kjo lejohet shprehimisht me ligj apo akt nënligjor, të lëshuar nga Këshilli.

4. Prokurorët dhe Kryeprokurorët, për aktivitete e parapara në këtë nen pranojnë shpërblim, i cili nuk mund të tejkalojë vlerën prej 25% (njëzetepesë) për qind të pagës bazë, dhe për këtë shpërblim prokurorët e njoftojnë Kryeprokurorin, kurse Kryeprokurorët e njoftojnë Këshillin.

Amendamenti 5 - dy propozime

A. Propozim i Komisionit FunkSIONAL

Neni 4 i Projektligjit fjalët “Paragrafi 2 i nenit 12 të Ligjit të ndryshuar, fshihet nga teksti.” **zëvendësohen me fjalët** “Neni 32/A i Ligjit bazik, paragrafi 2, fshihet”

B. Propozim i Deputetes Albulena Haxhiu - pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 4 i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034, hiqet dhe mbetet sikur në Ligjin 05/L-034.

Amendamenti 6 - Propozim i Deputetes Albulena Haxhiu - pa përkrahjen e Komisionit Funksional

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034, t'i shtohet një nen i ri dhe atë si në vijim:

“Për kryerjen e përgjegjësive të tyre, çdo prokurorë duhet të ketë nga një bashkëpunëtor profesional”